



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Procesverbali i dëgjimit publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në sektorin e Shëndetësisë, Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Dëgjimi publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në sektorin e Shëndetësisë, Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, u mbajt në sallën e kuvendit komunal, e ku të pranishëm ishin drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Adelina Stublla, drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë, dhe Sportit, Vlora Humolli dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, Shuajb Blakçori.

Dëgjimin publik e hapi drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu duke ju uruar mirëseardhje të pranishmëve dhe duke prezantuar projektet që janë në prioritet në fushën e Arsimit, pastaj ua kaloi fjalën qytetarëve për paraqitjen e kërkesave dhe sugjerimeve që ata kanë, dhe sipas mundësive buxhetore t'i inkuadrojnë ato në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Fatmir Emini- Drejtor i IAAP “Fan S. Noli”- Kërkon nga Komuna renovimin e shkollës brenda dhe jashtë.

Naim Bajrami- Drejtori i SHFMU “Zahir Pajaziti”, Orllan- Ka kërkesë për ndërtimin e një fushe sportive në oborrin e shkollës, renovimin e objektit të shkollës jashtë dhe brenda si dhe të rregullohen dy hyrjet e shkollës. Ndërkaq, ka kërkesë edhe për DKRS që të funksionalizohet objekti i vjetër i shkollës një pjesë si sallë leximi dhe pjesa tjetër si kinema.

Jeton Havolli- Përfaqësues nga Klubi i Tenisit- Kërkon nga Komuna të rregullohet infrastruktura për sportin e tenisit, duke thënë se ka shumë të interesuar për këtë sport, por për shkak të mungesës së infrastrukturës nuk mund të zhvillohet më shumë si sport.

Muhamet Jakupi- Drejtor i SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, Podujevë - Ka ngritur si problem që shkolla aktuale nuk i plotëson kushtet elementare për vijimin e mësimin, ku kërkon renovimin e shkollës, ndërtimin e një fushe sportive dhe rregullimin e parkingut të shkollës.

Blerim Zhitia- Drejtor i shkollës së fshatit Llugë- Ka pyetur Drejtoreshën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për buxhetin e teatrit se a është i ndarë nga buxheti i këtij sektori.

Fadil Zymeri- Drejtori i SHFMU “Nuhi Gashi”, Bradash- Kërkon ndërtimin e shkollës së re, për arsye se nuk i plotëson kushtet për vijimin e mësimin dhe ka mungesë të kabineteve.

Gazmend Havolli- Përfaqësuesi i Klubit të Karates ‘Llapi’- Ka sugjeruar për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që në çdo thirrje që hapët për subvencionim të organizatave të kërkohet në dokumentacionin për aplikim edhe plani vjetor i OJQ-ve.

Fehmi Pollomi -drejtori i SHFMU “Ish-Rilindja” në fshatin Herticë, Surdull- Ka kërkuar të bëhet renovimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës, kërkohen kabinete si dhe rregullimi i një fushe sportive, nëse ka mundësi të shtrohet pjesa e poshtme, sepse pjesa e betont tani është bërë pjesë pjesë gjë cka paraqet rrezik për nxënësit, gjithashtu edhe një kërkesë, në paralelen e ndarë në Surdull, të bëhet një intervenim i jashtëm, ne kemi intervenuar brenda me kushtet dhe mundësitë, por edhe pjesa e jashtme e objektit është e domosdoshme të rinovohet sidomos ollukt, qatia sepse kur po ka reshje dhe gjatë dimrit uji po hyn brenda, kështu qe nëse është mundësia, kemi nevojë edhe për kabinete nëse keni mundësi për të na pajisur si shkollë, sa i përket drejtorisë së Shëndetësisë e falendërojmë drejtoreshën për punën dhe kontributin, që të paktën një herë në javë të jetë e hapur që nëse edhe nxënësit lëndohen, dhe kur është mjeku të marrin shërbim, kështu që nëse ka mundësi edhe ai objekt të rinovohet, tjetër çështje kisha kërkua nga administrata, nëse është mundësia të bëhet pastrimi i rrugës, nga lagjia e Dëshmorëve e deri te kodra e Ballocit, sepse po hudhin shumë mbeturina dhe po kundërmon shumë erë e pakëndshme e sidomos tani gjatë verës.

Përfaqësuesi i Atletikës së Llapit”, kërkesa e anëtarësisë në klubin e atletikës së Llapit bëhet në hapësirën e stadiumit të Llapit, që lidhet me DKA dhe DKRS, nuk po kërkojmë një stadium olimpik por një stadium gjysmëolimpik, ku ka mundësi me u ndërtuar mes shkollës së Gjimnazit dhe shkollës teknike, nuk jam konsultuar me drejtorët paraprak, mirëpo ekziston si mundësi dhe aty mundemi pastaj të mbajmë garat shkollore, dhe po ashtu në at stadium të mbajmë orët mësimore, qe lidhen me atletikë dhe të njëjtën kohë ta shfrytëzoj atë pjesë për stërvitjen e tyre. E dimë që klubi i atletikës së Llapit ka më së shumti trofe nga të gjitha klubet në komunën tonë dhe mendoj që e meritojnë një stadium.

Një falenderim për drejtoreshën e Shëndetësisë për organizimin e kontrollave sistematike të nxënësëve, ka dhënë një efekt shumë pozitiv kështu që ju inkurajoj të vazhdoni.

Drejtori i shkollës së Orllanit Naim Bajrami - kemi një problem me një gropë septike, qysh me u lidh me kolektorin e ujërve të zeza, sepse qata ujë që po mbushet në gropë po derdhet në Liqenin e Batllavës, nëse ka mundësi përcillja drejtorit të Shërbimeve Publike.

Drejtori i drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu- nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë pyetje sa i përket pyetjeve të drejtorisë së Shërbimeve Publike ne i morëm pyetjet dhe kërkesat tuaja, i evidentuam dhe gjithashtu do ti përcjellim në njësinë përkatëse për t'i trajtuar, përndryshe po e ndjej të obliguar me ju informuar që ne jemi koncentruar në vitin 2025 mirëpo nuk do të thotë që në vitin 2026 dhe 2027 nuk do të jenë të përfshira kërkesat që i kemi diskutuar sot me ju, siç është kërkesa psh te shkolla në “Lagjien e Dëshmorëve”, për zgjerim të hapësirës së shkollës, ndërsa ne vitin 2026 është e domosdoshme edhe ndërtimi i sallës të edukatës fizike sepse ai vend e meriton edhe për shkak të numrit të nxënësve por edhe për shkak të vet lagjes, po ne po koncentrohemi në vitin 2025, ju treguam që ka një kodë të veçantë për renovime të hapësirave jashtë objektit shkollor dhe aty nuk është se i kemi vendosur te cilat shkolla do të intervenojmë, por gjithsesi na e dimë gjendjen e secilës shkollë, kemi intervenuar në shkolla brenda për brenda, ndërsa tani e dimë që është nevoja jashtë shkollave, për gjendjen e dritareve e kemi pak më problem se e kemi bënë një vlerësim, që kostoja e ndërrimit të tyre kap shifrën rreth 2 milion euro, dhe kjo është tani e pamundur, sepse ska mundësi tërë buxhetin ta orientojmë në dritare, çka është tjetër e rëndësishme që krahas buxhetit komunal që kemi të aplikojmë edhe në organizata që janë duke kontribuar në fushën e Arsimit, Kulturës dhe Shëndetësisë, mu më gëzon fakti që në shkolla teknike e udhëhequr nga drejtori Emini, nuk ka thirrje që hapet e që nuk aplikojnë drejtori me bashkëpunëtorë dhe si rezultat i kësaj, ka shumë projekte që janë përfituar në shkollë dhe kjo është praktikë e mirë që inkurajoj të gjithë shkollat të aplikojnë, këto ishin sa i përket drejtorisë së Arsimit, ndërsa në pyetjet tjera do të përgjigjen drejtorët nga drejtoritë përkatëse.

Drejtoresha e drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Adelina Stublla, falënderon drejtorin e shkollës së fshatit Herticë për sugjerimet dhe vlerësimet e punës së DSHMS, ne këtë vit planifikojmë të bëjmë renovimin e ambulantës, sepse me të vërtet ka nevojë, orari i punës vetëm një herë në javë është për shkak të transportit që e kemi diskutuar, faktikisht e vështirë të sigurojmë transport, e di që është nevoja që doktori të jetë aty çdo ditë mirëpo për shkak të mungesës së resurseve humane po ndodh kjo, po megjithatë kemi shërbimin paliativ falas, që përmes telefonit mund ta kontaktoni dhe ekipi do të dalin në shtëpitë e juaja për vizitë, shërbimi paliativ punon deri në orën 23, përfshirë edhe vikendet dhe festat, sa i përket punës së vizitave sistematike janë bërë edhe në kopshte edhe në shkolla në bashkëpunim me DKA, ne do të vazhdojmë këto vizita sepse e konsiderojmë të nevojshme.

Drejtor i shkollës së Bradashit- Fadil Zymeri, sa i përket fshatit Bradash ne jemi shumë të kënaqur me ambulatën tonë, qe shumë vite jemi në bashkëpunim me ta, mjeku është shumë i rregullt shumë bashkëpunëtor dhe rrjedhimisht edhe shërbimet e mira.

Drejtoresha e drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Jashanica-Humolli, po ja filloj përgjigjem prej shkollës së Orllanit, sa i përket objektit të vjetër besoj që shumë shpejt do të

marrim një iniciativë dhe do të rregullojmë, ndërsa sallën e leximit dhe qerdhen në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit besoj që do t'i buxhetojmë, te fusha e tenisit besoj që punimet do të përfundojnë në muajin korrik, pyetja e teatrit është a ka ndarë komuna buxhet, sepse kemi aktor të jashtëm dhe duhet me i inkuraju për me ardhë për të bërë shfaqje brenda teatrit të Podujevës, ndërsa për përgjigjen e Gazmendit- përfaqësuesit të klubit të Karates, uroj që projektin e ndërtuar që sado pak do të ju bëj zgjidhjen për ushtrimet e klubit në përgjithësi.

Drejtori i drejtorisë së Administratës, nëse keni ndonjë sygjerim, kërkesë, apo vërejtje sa i përket në shërbimet e administartës ju lutem adresojeni, të gjitha shërbimet e të gjitha drejtorive tani mund t'i merrni në katin e parë ku nga secila drejtori kemi të paktën nga një zyrtarë.

Avni Fetahu, nëse skeni ndonjë pyetje unë dua të përmyll këtë dëgjim publik të KAB me kaq duke ju falënderuar për kohën, kërkesat dhe sugjerimet tuaja.

11 Qershor- Podujevë







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve të dëgjimit publik për Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027  
Dëgjimi publik për sektorin e Shëndetësisë, Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	EADIL ZYMERI	BRADASH		
2	SHAIP MEHANA	BATLLAVE		
3	MAHMUT REXHEPI	Podujevë		
4	Blerim Zhizia	Ulçine		
5	Naimi Baxhami	Dallos		
6	Lumbaro Gashi	Podujevë		
7	Jeton Hajrullari	Podujevë		
8	Sehmi Pallami	Hotice		
9	Muhamet Jakupi	Podujevë		
10	Enver Mehdiu	BATLLAVE		
11	Lulzim Ajvazi	Prishtë		
12	Ismail Kasnaji	Prishtë		
13	Visnar Zhushi	Svegël		
14	Bahiti Blakoshi	Letimorë		
15	Muhamed Selman	Podujevë		
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				

29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

***Vërejtje: Njoftohen të gjithë pjesëmarrësit e takimit se të dhënat e listës së nënshkrimeve dhe fotot përdoren për postime në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës!***

Podujevë

11.06.2024